

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

Matura 2021

UDHËZUES PËR VLERËSIMIN E PËRGJIGJEVE TË NXËNËSVE

SESIONI I

LËNDA: EKONOMI

VARIANTI : A

Pyetja 1 C

Pyetja 2 3 pikë

Tipare thelbësore:

- **Ekonomia para viteve 90'**: qeveria vendoste si/çfarë/për kë do të prodhohet - **Ekonomia e tregut**: si/çfarë/për kë vendosen në treg nga ballafaqimi i kërkesës dhe ofertës.
- **Ekonomia para viteve 90'**: gjithë aktivitetet e subjekteve ekonomike dhe koordinimi i tyre ishin të centralizuar në duart e shtetit - **Ekonomia e tregut**: funksionet kryesore koordinuese të subjekteve ekonomike i kryen tregu.
- **Ekonomia para viteve 90'**: shteti zotëronte burimet natyrore dhe mjetet/faktorët e prodhimit – **Ekonomia e tregut**: ekziston prona private mbi kapitalin dhe burimet prodhuese.
- **Ekonomia para viteve 90'**: pagat, shpërblimet, çmimet vendoseshin nga shteti - **Ekonomia e tregut**: pagat, shpërblimet, çmimet përcaktohen nga tregu.
- **Ekonomia para viteve 90'**: i pamundur ballafaqimi i kërkesës me ofertën - **Ekonomia e tregut**: bazohet në ballafaqimin e D dhe S.
- **Ekonomia para viteve 90'**: sipërmarrja private nuk lejohej - **Ekonomia e tregut**: sipërmarrja lejohet.

3 pikë Nëse krahason tri tipare thelbësore.

2 pikë Nëse krahason vetëm dy

1 pikë Nëse krahason vetëm një.

Shënim: Nxënësi mund të krahasojë edhe tipare të tjera, të cilat nuk i përmban skema e vlerësimit dhe do të marrë pikë nëse komisioni i gjykon të sakta.

EKONOMI

- Pyetja 3** **A** **1 pikë**
Pyetja 4 **C** **1 pikë**
Pyetja 5 **C** **1 pikë**
Pyetja 6 **C** **1 pikë**

Pyetja 7 (a) **1 pikë**

Sasia ekuilibër: $Q_e = 50$

Çmimi ekuilibër $P_e = 50$

1 pikë Nëse identifikon sasinë dhe çmimin ekuilibër.

0 pikë Nëse identifikon vetëm njërin, përgjigjet gabim ose nuk ka asnjë përgjigje.

Pyetja 7 (b) **1 pikë**

Sasia ekuilibër: $Q_e = 30$


Çmimi ekuilibër $P_e = 60$

1 pikë Nëse identifikon sasinë dhe çmimin ekuilibër.

0 pikë Nëse identifikon vetëm njërin, përgjigjet gabim ose nuk ka asnjë përgjigje.

Pyetja 7 (c)

1 pikë



EKONOMI

Pyetja 8 (a) 1 pikë

Kërkesa për bukë ndaj kërkesës për bizhuteri:

1 pikë Kërkesa për bukë është (relativisht) më pak elastike se kërkesa për bizhuteri.

Pyetja 8 (b) 1 pikë

1 pikë Kërkesa për stilolapsa është (relativisht) më pak elastike se kërkesa për makina.

Pyetja 9 C 1 pikë

Pyetja 10 B 1 pikë

Pyetja 11 4 pikë

Përparësitë:

- Lehtësi dhe shpejtësi në organizimin e firmës dhe marrjen e vendimeve.
- Kërkojnë më pak fond/kapital fillestar për t'u investuar.
- Taksa të ulëta vjetore.
- Mbi këto firma nuk vepron taksimi i dyfishtë.
- Fitimi nuk ndahen me askënd, por përfitohet i tërë nga pronari.
- Pronari ushtron funksionin edhe të menaxherit.
- Liri më e lartë veprimi.
- Bashkimi i funksionit të pronarit me atë të menaxherit.
- Pronarët e firmave individuale kanë mundësi të arrijnë suksesin më shpejt.

Të metat:

- Përgjegjësi e pakufizuar.
- Jetëgjatësi e kufizuar në varësi të jetëgjatësisë së pronarit.
- Kapital i kufizuar dhe vështirësi në rritjen e tij.
- Drejtim i kufizuar, në varësi të formimit profesional dhe intelektual të pronarit.
- Mundësi të kufizuara lidhur me punësimin e punëtorëve, përmasat e biznesit, burimet menaxheriale.

2 pikë Nëse identifikon dy përparësi.

2 pikë Nëse identifikon dy të meta.

Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigje nuk i përmbahet modelit të dhënë në skemë, por që komisioni e gjykon si të saktë.

Pyetja 12 D 1 pikë

Pyetja 13 (a) 1 pikë

Ç'kuptim ka kostoja e përgjithshme e barabartë me 5 lek në nivelin zero të prodhimit?

1 pikë Kostoja e përgjithshme e barabartë me 5 lek në nivelin zero të prodhimit është kosto fikse FC.

Pyetja 13 (b) 1 pikë

Sa është kosto variabël kur firma ka prodhuar 4 njësi produkt?

1 pikë $VC_{(Q=4)} = TC_{(Q=4)} - FC = 21 - 5 = 16$ lek

Pyetja 13 (c) 1 pikë

Sa është kosto marginale kur firma kalon nga niveli i 2 në të 3 të prodhimit?

1 pikë $MC = \Delta TC / \Delta Q = (18 - 14) / 3 - 2 = 4$ lek

Pyetja 14 2 pikë

Pengesat:

- Kostoja e prodhimit ose ekonomizimet/ekonomitë e shkallës – pengesë ekonomike
- Zotërimi i burimeve kryesore në procesin e prodhimit - pengesë ekonomike
- Patenta – pengesë ligjore
- Licensa - pengesë ligjore
- Marka tregtare - pengesë ligjore
- E drejta e autorit - pengesë ligjore

2 pikë Nëse identifikon dy pengesa.

1 pikë Nëse identifikon vetëm një pengesë.

Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigje nuk i përmbahet modelit të dhënë në skemë, por që komisioni e gjykon si të saktë.

EKONOMI

Pyetja 15 A 1 pikë

Pyetja 16 B 1 pikë

Pyetja 17 3 pikë

- emetimi i parave (shtypja e kartmonedhave të tjera)
- huamarrja
- rritje e taksave/tatimeve
- reduktimi i shpenzimeve publike
- përdorimi i rezervave të akumuluarra prej tepricave të mëparshme buxhetore

3 pikë Nëse liston tri mënyra.

2 pikë Nëse liston dy mënyra.

1 pikë Nëse liston një mënyrë.

Pyetja 18 3 pikë

Rreziku kryesor:

1 pikë Falimentimi

Masat:

- Mbajtja e rezervave të mjaftueshme
- Maturi në dhënie e huave
- Optimizimi i fitimeve në raport me sigurinë e bankës

2 pikë Nëse identifikon dy masa.

1 pikë Nëse identifikon vetëm një masë.

Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigje nuk i përmbahet modelit të dhënë në skemë, por që komisioni e gjykon si të saktë.

Pyetja 19 2 pikë

Në Korçë punësohen më tepër edukatorë në kopshte: *Shpenzim qeveritar*

Fabrika MODA prodhon veshje në Tiranë dhe i shet në Itali: *Eksport*

1 pikë Nëse identifikon veprimin e parë.

1 pikë Nëse identifikon veprimin e dytë.

EKONOMI

Pyetja 20 D 1 pikë

Pyetja 21 A 1 pikë

Pyetja 22 B 1 pikë

Pyetja 23 (a) 1 pikë

Forca punëtore (në total individësh)

1 pikë Forca punëtore = Nr. i të punësuarve + Nr. i të Papunëve = 900,000 + 500,000 = 1 milion e 400 mijë individë (ose 1,400,000)

Pyetja 23 (b) 1 pikë

Norma e papunësisë (u) (%) = $(\text{Nr i të Papunëve} / \text{Forcë punëtore}) \times 100 = (500,000 / 1,400,000) \times 100 = 35.7\%$

1 pikë Nëse gjen normën e papunësisë.

Pyetja 23 (c) 1 pikë

Papunësinë Natyrore (në total individësh):

1 pikë Papunësia Natyrore (në total individësh) = Nr. i të Papunëve friksionalë + Nr. i të Papunëve Strukturorë = 120,000 + 80,000 = 200,000 individë.

Pyetja 23 (d) 1 pikë

Norma e papunësisë në punësim të plotë (në %)

1 pikë Norma e papunësisë në punësim (punëzënie) të plotë (në %) është e barabartë me: $(\text{Nr. total i individëve në Papunësi natyrore} / \text{Forcë Punëtore}) \times 100 = (200,000 / 1,400,000) \times 100 = 14.2\%$.

Pyetja 24 B 1 pikë

Pyetja 25 A 1 pikë

Pyetja 26 B 1 pikë

Pyetja 27 A 1 pikë

Pyetja 28 B 1 pikë

EKONOMI

Pyetja 29 3 pikë

Disa arsye që e bëjnë të vërtetë pohimin:

- Gjuha kombëtare
- Ndryshimet në kuadrin ligjor midis vendeve
- Vlerat/ zakonet dhe traditat e ndryshme midis kombeve
- Përparësitë e ndryshme midis kombeve

3 pikë Nëse identifikon tri arsye.

2 pikë Nëse identifikon dy arsye

1 pikë Nëse identifikon një arsye.

Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigje nuk i përmbahet modelit të dhënë në skemë, por që komisioni e gjykon si të saktë.

Pyetja 30 C 1 pikë

Pyetja 31 2 pikë

Elementët:

- Bashkëpunimi me të tjerët
- Krijimi i sinergjisë në grup
- Marketimi i vetvetes
- Flas në mënyrë që të tjerët të kuptojnë
- Planifikoj
- Reflektoj dhe vlerësoj

2 pikë Nëse identifikon dy arsye

1 pikë Nëse identifikon vetëm një arsye.

Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigje nuk i përmbahet modelit të dhënë në skemë, por që komisioni e gjykon si të saktë.

Pyetja 32 3 pikë

Shpenzime të ndryshueshme:

- shpenzimet për argëtime (por edhe shembuj të tjerë të barazvlefshëm në bazë të përkufizimit)
- shpenzimet për vizita mjekësore (dhe shembuj të tjerë).

2 pikë Nëse identifikon dy shembuj.

1 pikë Nëse identifikon vetëm një shembull.

Shpenzime të pandryshueshme:

- qeraja e apartamentit
- pagesa mujore e shkollës (dhe shembuj të tjerë).

1 pikë Nëse identifikon një shembull.

Pyetja 33 A 1 pikë

Pyetja 34 3 pikë

- Biznesi mund të ndryshojë/përmirësojë cilësinë
- Biznesi mund të ndryshojë vlerën
- Biznesi mund të ndryshojë mënyrën se si ofron produktin

3 pikë Nëse argumenton tri mënyra.

2 pikë Nëse argumenton dy mënyra.

1 pikë Nëse argumenton vetëm një mënyrë.

Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigje nuk i përmbahet modelit të dhënë në skemë, por që komisioni e gjykon si të saktë.